

“NUMRI NJË I BANKËS SË SHQIPËRISË FLET PËR LUHATJET E MONEDHËS VENDASE”.

Intervistë dhënë gazetës “Gazeta shqiptare”, në 14 gusht 1999.

- “Është tregu dhe vetëm tregu, i cili ka vendosur për kursin e këmbimit të lekut me valutat”.
- “Leku ka shkuar në Kosovë .Nga të dhënat që ne kemi ,nuk është në ato përmasa që të shqetësohet ekonomia shqiptare, por këto s’janë të dhëna të drejtpërdrejta që ne mund të masim se sa para janë atje”.
- “Asnjëherë nuk duhet të jetë inflacioni më i lartë sesa përqindja e interesit të depozitave, që duhet të japë banka.”

Cani:Ja pse është forcuar leku.

“Një nga shkaqet, nuk është kredituar ekonomia”.

Është tregu dhe vetëm tregu, që ka vendosur për kursin e këmbimit të lekut me valutat”. Kështu, ka deklaruar në një intervistë për Gazetën, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Shkëlqim Cani, duke përjashtuar çdo mundësi të ndërhyrjes së bankës, që ai drejton, në tregun e lirë për të shmangur mbivlerësimin e mëtejshëm të monedhës kombëtare. Sipas tij, “forcimi i lekut teorikisht do të sillte rënie të eksporteve dhe të investimeve dhe nga ana tjetër nxitje të importeve. Por, aktualisht, në rastet e para ka ndodhur e kundërta dhe kjo teori nuk është vërtetuar”.

Është parashikuar që deri në fund të vitit 1999 ,kursi mesatar i këmbimit të monedhës shqiptare me dollarin të jetë 147 lekë dhe aktualisht është rreth 132 lekë. Kaq i fortë është në të vërtetë leku?

“Kursi mesatar 147 lekë- një dollar është një tregues përlllogaritës. Gjithnjë një buxhet apo një ekonomi ka nevojë të bëjë përlllogaritje, por që është 147 ose jo, ky nuk është fare tregues. Nuk e ka askush për detyrim që të mbajë këtë kurs këmbimi. Është bërë një përlllogaritje, që në një ekonomi normale kursi i këmbimit të dollarit mund të ishte 147 lekë. Natyrisht, ekonomia shqiptare me një rrjedhë normale pasi shumë ngjarje rrodhën gjatë kësaj kohe, të cilat do të ndikonin në të gjithë spektrin e ekonomisë

pjesë e të cilit është edhe kursi i këmbimit. Është tregu dhe vetëm tregu që ka vendosur për kursin. Sigurisht, që nuk mund të flasim për një treg real, bashkëkohor, modern, si në të gjithë botën ku fjalën e fundit e thotë elektronika. Është një treg me ato të metat e veta që bëhet në rrugë, që ka pak perceptime elektronike, tregjet janë të ndara në të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, me pak ndryshime dhe tregu shqiptar pothuajse ndjek atë ndërkombëtar, ndonëse është në zanafillën e vet. Është apo nuk është i fortë leku, kjo nuk varet nga kursi. Nuk është kursi, që tregon forcën e lekut, pasi mund të tregojë edhe dobësinë e tij.”

Cilat janë efektet e forcimit të lekut në ekonominë shqiptare?

“Ekonomia shqiptare influencohet nga forcimi i lekut në disa sektorë por pak janë ata që e ndiejnë këtë forcim. Më kryesorët janë import-eksporti, pra tregtia në tërësi dhe investimet. Një lek më i fortë duhet të sjellë, në kushte ideale dhe teorike, një nxitje të importeve dhe pengim të eksporteve. Por, çfarë ndodh në ekonominë shqiptare? Në fakt mund të duket paradoks, por nuk është kështu, sepse eksportet shqiptare janë drejt eksporteve natyrore, pra eksportojmë atë çka prodhojmë. Ndërkohë, sipas të dhënave rezultojnë se eksportet janë rritur.

Përsa i përket importeve nxitja e tyre nuk është e mirë, pasi një ekonomi duhet të nxisë prodhimin e vendit. Por, një ekonomi nuk nxit prodhimin e vendit me minuta dhe me ditë, sepse duhet një strategji e cila shtrihet në vite, pasi duhet të fillosh të investosh të aktivizosh degët e ekonomisë. Pra, ka shumë probleme, që janë të lidhura me kreditimin dhe me heqjen e rrezikut të një ekonomie të një vendi dhe Shqipëria ishte një vend, që kishte kryesisht rrezik nga faktori i jashtëm, veç korrupsionit dhe kontrabandës, që zhvillohet në vend. Por, mendoj se forcimi i lekut nuk është kryefaktori, që i ka shkaktuar një nxitje importeve. Ndërkohë, forcimi i lekut ka sjellë edhe anën pozitive, sepse janë nxitur importet me çmimet relativisht më të ulta. Pra, populli si pasojë e forcimit të lekut, ka përfituar në uljen e çmimeve të mallrave të importit. Përsa i përket investimeve, ato nuk janë penguar aq shumë nga forcimi i lekut. Janë arsye të tjera ato që kanë penguar. Nuk është kredituar ekonomia, pasi ishim një rajon që ra e keqja e luftës, por edhe stabiliteti në Shqipëri nuk është në shkallën e duhur.”

Ky kurs këmbimi parashikohet të jetë në këto nivele deri në fund të gushtit. Po nëse vazhdon i tillë edhe më gjatë, ç’masa do marrë Banka e Shqipërisë?

“Unë nuk jam një magjisttar, por një Guvernator. Jua thashë që në fillim dhe do t’jua them përsëri, se unë nuk e di se si do të shkojë vlera e lekut ,pasi po ta dija do të isha një ndër pasanikët e Shqipërisë duke bërë manovra në treg. Vlerën e lekut e vendos vetëm tregu. Tregu është kapriçioz dhe ka rregullat e veta. Por, është në traditën historike të Shqipërisë, që deri në fund të gushtit, për shkak të rritjes të ardhjes së emigrantëve, të rënies së importeve, sepse fillon prodhimi në vend, të rritet dhe vlera e lekut.

Megjithatë, në tërësi në të gjitha vendet e Ballkanit ku ne importojmë rritet prodhimi. Pra, rënia e çmimeve dhe forcimi i monedhës kombëtare ndodh për efekte sezonale në të gjithë rajonin dhe jo vetëm në Shqipëri. Nga ana tjetër, rriten edhe të ardhurat nga veprimtaria ilegale, për shembull në Vlorë shërbehet më mirë ndaj emigrantëve ilegalë, pasi deti është më i qetë. Por, është e thënë që Shqipëria duhet të respektojë patjetër treguesit historikë. Ne si Bankë Shqipërie e kemi për detyrë të themi, deri në fund të gushtit është tradita e forcimit të lekut. Por, a do të vërtetohet ose jo edhe këtë vit, nuk mund ta themi dot me siguri. Nga ana tjetër, ajo që nuk i pëlqen Bankës së Shqipërisë është luhatja e kursit të këmbimit në nvele të larta brenda ditës. Këtu ne ndërhyjmë që të mos lejojmë ndikimin e faktorëve psikologjikë dhe keqpërdorim të tyre, por nuk ndërhyjmë direkt në rastet e luhatjeve të kursit në një kohë më të gjatë pasi kaq i vendos tregu vlerat e lekut dhe po kaq i kërkon ekonomia. Një nga rastet e ndërhyrjes indirekte, është ulja e përqindjeve të interesit të depozitave.”

Sipas jush deri në çfarë niveli do të shkojnë përqindjet e interesit të depozitave në bankat e nivelit të dytë?

“Përqindja e interesit të depozitave ka të bëjë kryesisht me inflacionin si faktor kryesor. Ne kemi një shprehje dhe themi se interesat realë duhet të jenë pozitivë. Por, çfarë do të thotë kjo? Banka e Shqipërisë është e angazhuar, që të mbrojë depozituesit në këtë drejtim. Asnjëherë nuk duhet të jetë inflacioni më i lartë se sa përqindja e interesit, që duhet të japë banka. Duhet t’i bëjmë të interesuar depozituesit, që të fusin para dhe të nxjerrin një fitim minimal, por ky fitim të mos jetë i përmasave të mëdha, që duke ndenjur të fitosh, pasi në këtë rast krijohen ato që quhen piramida. Pra, nëse inflacioni qëndron zero, atëhere normat e interesit do të jenë rreth 6 për qind, nëse inflacioni do të jetë 8 për qind, atëhere normat e interesit do të jenë rreth 10 për qind. Kështu që, bazuar në këta shembuj do të jetë edhe ecuria e normave të interesit për depozitat.”

Sasia e lekut që ka shkuar në Kosovë, çfarë efektesh do të sjellë në ekonominë shqiptare?

“Leku ka shkuar në Kosovë. Megjithatë, nga të dhënat që kemi, nuk është në ato përmasa që të shqetësohet ekonomia shqiptare, por këto nuk janë të dhëna të drejtpërdrejta që ne të mund të masim se sa para janë atje. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë vazhdon hulumtimet, në mënyrë që ta njohë më mirë gjendjen reale atje.”